




REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT
ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT BASHA&I SH.P.K



Nr.977(201/32) i Aktit

Tirane, me 07.09.2023

Lenda: Komunikim Vendim pezullimi i Gjykates se Larte nr. 412, date 03.08.2017

Drejtuar : QENDRA KOMBETARE E BIZNESIT (Q.K.B)

Per djeni : Debitorit Shoqeria "ALBCONTROL"sh.a me nr.NIPT J61908011H
Kreditorit Shkelqim Lamçe

Unë, Farije Istrefi, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor Privat, pranë Zyrës së Përmbarimit Privat "**Basha & I**" SHPK konstatova se me Urdher te Ministrise se Drejtesise me eshte transferuar nga permbaruesja Irista Tereziu PF për ekzekutim Urdheri i Ekzekutimit me Vendimin nr.454/U, date 27.01.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, per zbatimin e titullit ekzekutiv, Vendim nr.454, date 27.01.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me Vendim nr.1594, date 22.06.2017 te Gjykates se Apelit Tirane me kreditor Shkelqim Lamçe dhe debitor Shoqeria "ALBCONTROL"sh.a me nr.NIPT J61908011H.

Bashkangjitur do te gjeni:

- Shkresen date 28.08.2017 Vendim per Pezullim e Ekzekutimit me Vendim Gjykatë.
- Vendim nr.412, date 03.08.2017 te Gjykates se Larte per pezullimin e ekzekutimit te Vendimit nr.454, date 27.01.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me Vendim nr.1594, date 22.06.2017 te Gjykates se Apelit Tirane.

ZYRA E PERMBARIMIT PRIVAT BASHA & I SH.P.K

PERMBARUESI GJYQESOR

Farije Istrefi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E LARTË
KOLEGJI CIVIL



Nr. 412 i Vendimit

V E N D I M
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë i përbërë nga:

Xhezair Zaganjori - Kryesues
Artan Zeneli - Anëtar
Admir Thanza - Anëtar

më datën 03.08.2017 mori në shqyrtim në dhomën e këshillimit çështjen civile me:

KËRKUES: ALBCONTROL sh.a.

OBJEKTI: Pezullimin e titullit ekzekutiv lëshuar për Vendimin nr. 454 datë 27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

BAZA LIGJORE: Neni 479 i Kodit të Procedurës Civile

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendimin nr. 454, datë 27.01.2016, ka vendosur: Pranimin e kërkesë – padisë. Konstatimin e zgjidhjes së kontratës së punës me shkresën Nr. 594 Prot. dt. 11. 03. 2014 si zgjidhje e menjëhershme dhe e pajustifikuar. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Albcontrol" sh.a. t'i paguajë paditësit Shkëlqim Lamçe si dëmshpërblim pagën e 12 (dhjetë) muajve punë për shkak të zgjidhjes së menjëhershme të pajustifikuar të kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Albcontrol" sh.a. t'i paguajë paditësit Shkëlqim Lamçe si dëmshpërblim pagën e 3 (tre) muajve punë për shkak të mos respektimit të afatit të njoftimit për zgjidhjen e kontratës së punës. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Albcontrol" sh.a. t'i paguajë paditësit Shkëlqim Lamçe si shpërblim për vjetërsi në punë pagën e 6 (gjashtë) muajve punë. Detyrimin e palës së paditur Shoqëria "Albcontrol" sh.a. t'i paguajë paditësit Shkëlqim Lamçe pagën e muajit Shkurt të vitit 2014 deri në 11 Mars të vitit 2014 si pagë e papaguar. Si pagë referuese për pagimin e dëmshpërblimeve të merret paga e fundit bruto e paditësit në shumën 141,909 Lekë në muaj. Shpenzimet gjyqësore në ngarkim të palës së paditur.

Gjykata e Apelit Tiranë me vendimin nr. 1594, datë 22.06.2017 ka vendosur: Lënien në fuqi të vendimit nr. 454, datë 27.01.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Kërkuesi, Shoqëria "ALBCONTROL sh.a, ka paraqitur në Gjykatën e Lartë kërkesë me të cilën kërkon pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv lëshuar për Vendimin nr. 454 datë

27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë i cili është lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 22.06.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.



KOLEGJI CIVIL I GJYKATËS SË LARTË

pasi dëgjoi relacionin përkatës dhe diskutoi çështjen në tërësi, në dhomën e këshillimit,

V Ë R E N

Kërkesa e paraqitur nga kërkuesi, ALBCONTROL sh.a, me të cilën kërkon pezullimin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv lëshuar për Vendimin nr. 454 datë 27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 479 i Kodit të Procedurës Civile.

PËR KËTO ARSYE

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, në bazë të nenit 479 të Kodit të Procedurës Civile

V E N D O S I

Pezullimin e ekzekutimit të Vendimit nr. 454 datë 27.01.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, lënë në fuqi me vendimin nr. 1594, datë 22.06.2017 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

Tiranë, me 03.08.2017

ANËTAR

ARTAN ZENELI

ANËTAR

ADMIR THANZA

KRYESUES

XHEZAIR ZAGANJORI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA KOMBETARE E PERMBARUESVE GJYQESOR PRIVAT
PERMBARUES GJYQESOR PRIVAT IRISA TEREZIU



Tirane, me 28.08.2017

VENDIM

“PER PEZULLIMIN E EKZEKUTIMIT ME VENDIM GJYKATE”

Une Irista Tereziu, me detyre permbaruese gjyqesore private, me Certificate nr 218 Janar 2015, me numer Nipt L51526008U, pasi studiova dosjen permbarimore nr.201, date 21.07.2017, qe ju perket paleve me:

Kreditor: Shkelqim Lamçe
Debitor : Shoqeria “ALBCONTROL”sh.a me nr.NIPT J61908011H
Objekt : Pagim Detyrimi

KONSTATOVA :

Se Gjykata e Larte me Vendimin nr.412, date 03.08.2017 ka vendosur pezullimin e ekzekutimit te Vendimit nr.454, date 27.01.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me Vendim nr.1594, date 22.06.2017 te Gjykates se Apelit Tirane.

Ne baze te nenit 615/a te K.Pr.Civile:

VENDOSA:

1.Te pezulloj ekzekutimin e Urdherit te Ekzekutimit, Vendim nr.454/U, date 27.01.2016, per zbatimin e titullit ekzekutiv, Vendim nr.454, date 27.01.2016 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, lene ne fuqi me Vendim nr.1594, date 22.06.2017 te Gjykates se Apelit Tirane.

2.Dosja permbarimore kalon ne Arkivin e kesaj zyre dhe ruhet ne baze te rregullave te percaktuara me ligj.

3.Nga nje kopje Vendimit nr.412, date 03.08.2017 te Gjykates se Larte ju dergohet paleve per dijeni.



